REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS**

## PROCES VERBAL

**Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Janar 2026**

**Data 29.01.2025 ora 14:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallen e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Rendi i dites:**

**1.**Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 23.12.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

**2.**Projekt vendim për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026.

**3.**Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025.

**4.**Projekt vendim për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të grantit të bazuar në performancë të Bashkisë Vau Dejës me burim financimi nga financimi i huaj.

**5.**Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Lush Kol Kolndrekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

**6.**Projekt vendim për miratimin e listes së kërkuesve për programin e strehimit social " Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme " ( Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuar).

**7.**Projekt vendim për vazhdimësinë dhe vleren e përfitimit për Z.Ndrec Tanushi dhe Z.Ardjan Lekaj në programin e strehimit "subvencionit të qirasë në tregun e lirë"

**8.**Projekt vendim për miratimin paraprak të planit të mbarështimit në ekonominë pyjore Gjader Mnelë në administrim të Bashkisë Vau Dejës.

**9.**Projekt vendim për miratimin e listes së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe të pyjeve që kulloten.

**10.**Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim.

**11.**Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025, banorë të Bashkisë Vau Dejës.

**12.**Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjes së shtetasit Mark Zef Prendi i dëmtuar nga zjarri me datë 16.12.2025, banor i Bashkisë Vau Dejës.

**13.**Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes u zhvillua me datë 29.01.2026 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj,Gjovana Corri), korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalen për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj -kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Rendi i ditës u miratua me 18 vota Pro. Këshilltarët që votuan pro,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj,Gjovana Corri)

**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 23.12.2025 si dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 23.12.2025 nga Z.Ervis Shimaj.Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij. Këshilltarët që votuan pro,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj,Gjovana Corri)

Në këtë moment bëhet pjesë prezent në mbledhje Znj.Meliha Zyberaj dhe korumi i mbledhjes bëhet 19 këshilltarë prezent.

Z.Ervis Shimaj propozon që të shqyrtohen fillimisht pika 11 dhe 12 e rendit të ditës, pasi relatorja Znj.Valjeta Nikaj paraqiti arsye familjare se nuk mund të qëndronte deri në fund të mbledhjes.Këshilltarët shprehen dakortesi që fillimisht të shqyrtohen pika 11 dhe pika 12 e rendit të ditës.

**Për këtë arsye Z.Ervis Shimaj lexon piken 11 të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025, banorë të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj – përgjegjese e zyres emergjencave civile pranë Bashkisë Vau Dejës e cila spjegon se është ndjekur procedura ligjore dhe janë bërë verifikimet në terren me grupin e punës dhe sipas legjislacionit në fuqi propozojmë që të jepet ndihmë finaciare të menjëhershme familjeve që janë dëmtuar nga përmbytjet me datë 26.10.2025,

gjithsejt 38 familje me vlerë 50% e dëmit prej 5.140.260 lek, shumë e cila do mbulohet nga buxheti i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 11 të rendit të ditës,(Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj,Gjovana Corri,Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 12 të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës finaciare të menjëhershme familjes së shtetasit Mark Zef Prendi i dëmtuar nga zjarri me datë 16.12.2025, banor i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar Znj.Valjeta Nikaj – përgjegjese e zyres emergjencave civile pranë Bashkisë Vau Dejës e cila spjegon se për hartimin e projekt vendimit është zbatuar me korrektësi ligji dhe udhëzimet ligjore për fatkeqesitë e shkatuara nga zjarri.Propozojmë që si pasojë e dëmtimit të banesës nga zjarri i datës 16.12.2025 ti jepet ndihmë finaciare të menjëhershme familjes së shtetasit Mark Zef Prendi, banor i Bashkisë Vau Dejës. në masën 50% të vlerës totale në shumën 265.357lek, shumë e cila do mbulohet nga buxheti i Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 19 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 12 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj,Gjovana Corri,Meliha Zyberaj).

Në këtë moment largohet nga mbledhja Znj.Gjova Corri dhe në sallë mbeten 18 këshilltarë prezent.

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 2 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2026.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë për miratim kriteret specifike te vitit 2026 mbi te cilat do te bazohet VKB per te trajtuar me ndihmë ekonomike duke perdorur deri ne 6% te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike familjet te cilat nuk shpallen fitues sipas formules se pikezimit.Znj. Elidona Lisi relaton kriteret e propozuara.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 2 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina

Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 3 të rendit të ditës:**

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2025.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Elidona Lisi -perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Dhjetor 2025 familje 125, me 404,233 lekë, me 5.98% e fondit total.Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Dhjetor 2025 janë shpallur fitues, 881 familje, me fond 6,763,811 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 405,828 lekë.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 3 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 4 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të grantit të bazuar në performancë të Bashkisë Vau Dejës me burim financimi nga financimi i huaj.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Znj.Armena Zagani- përgjegjëse e zyres financë buxhetit, Bashkia Vau Dejës e cila në vendimin e komisionit të Vlersimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025 ne si Bashki jemi vlerësuar sipas kritereve specifike të kërkuara dhe si rezulat sipas nivelit të performancës kemi përfituar një fond prej 4,333,634.43 lekesh me burim financimi nga financimi i huaj. Me anë të këtij projekt vendimi ashtu sic na orienton dhe Ministria e Financave sipas shkresës së përmendur më sipër ne jemi angazhuar ne detajimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi, bazuar në Udhëzimin e Përbashkët Nr 01 date 11.07.2025 "Për kriteret procedurat dhe treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025".Ky fond do të përdoret për zërin e buxhetit"Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të pa favorizuara+Mbikqyrje+Kolaudim" me kod produkti 1570372, programi 10661, me kapitull 02. Ky projekt është pjesë e projekteve prioritare miratuar me VKB nr 76 datë 23.12.2025 "Për miratimin e projekteve prioritare të investimeve në Bashkinë Vau Dejës me Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkoder nr 884/1 datë 07.01.2026.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 4 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 5 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për pranimin e të moshuarit Z.Lush Kol Kolndrekaj në Qendren e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa" Barbullush.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Znj.Marketa Lleshaj-specialiste pranë zyres shërbimit social Bashkia Vau Dejës e cila shprehet se mbështetur në kërkesën e paraqitur pranë Sektorit të Shërbimit Social. Bashkia Vau Dejës të Z.Lush Kol Kolndrekaj për sistemimin e tij në qëndren për të moshuar "BESA" Barbullush, është një i moshuar që aktualisht jeton vetem dhe perballet me vështiresi nëe permbushjen e nevojave te perditshme.Duke marrë parasysh moshen gjendjen shendetsore, vetmine dhe mungesen e kujdesit familjar, propozohet akomodimi i tij ne Qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar "Besa", Barbullush", ku do mund te marre perkujdesjen e nevojshme, sherbimet baze te jetetses, ndihmen mjeksore dhe mbeshtetje sociale te vazhdueshme.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 5 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 6 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e listes së kërkuesve për programin e strehimit social " Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme " ( Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pa favorizuar).

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Znj.Dajana Lleshaj-përgjegjëse zyres strehimit, Bashkia Vau Dejës, e cila relaton për këshilltarët se fillimisht janë mledhur 55 dosje të aplikuesve 2024-2025 ku nga 10 dosje jane skualifikuar paraprakisht pasi 8 banorë në momentin që janë telefonuar për tu informuar për sjelljen e dokumentacionit kanë komunikuar që për arsye të ndryshme nuk dëshirojnë të vazhdojnë procedurat e dokumentave dhe 2 banorë kanë dalë përfitues në vitet paraardhëse në përputhje me parimet e ligjit nr. 22/2018 i Strehimit Social i ndryshuar dhe akteve nënligjore të tij. Komisioni i strehimit shqyrtoi 45 dosje nga të cilat rezultoi që 14 aplikues skualifikohen për mungesë dokumentacioni. Komisioni pas shqyrtimit të dosjeve, vendosi për kualifikimin e 27 aplikuesve si kërkues me dokumentacion të rregulltë për tu përfshirë në trajtimin e programeve në projektet e mbeshtetura nga Bashkia dhe buxheti i shtetit.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 6 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 7 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për vazhdimësinë dhe vleren e përfitimit për Z.Ndrec Tanushi dhe Z.Ardjan Lekaj në programin e strehimit "subvencionit të qirasë në tregun e lirë"

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Znj.Dajana Lleshaj-përgjegjëse zyres strehimit, Bashkia Vau Dejës, e cila relaton për këshilltarët se subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg. Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr.57.dt.27.10.2025, Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 me 26.03.2025 "Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit ", realizoi mbledhjen në datën 12.12.2025.Ku u be shqyrtimi i dokumentacionit të plotë i rinovuar dhe kontratat e qirasë noteriale për banorët z. Ndrec Tanushi dhe z.Ardjan Lekaj.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 7 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 8 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin paraprak të planit të mbarështimit në ekonominë pyjore Gjader Mnelë në administrim të Bashkisë Vau Dejës.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Z.Mark Suli- inxhinjer, specialist zyra e pyjeve Bashkia Vau Dejës i cili spjegon se Bashkia Vau i Dejës, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, ndër të cilët është edhe administrimi i pyjeve dhe kullotave vendore sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ka në administrimin e saj gjithsej 31,118 ha Pyje dhe Kullota.Pjesë e këtij administrimi është edhe ekonomia pyjore Gjadër Mnelë, për të cilën është realizuar plani i mbarështimit të Pyjeve dhe kullotave.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 8 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 9 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e listes së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe të pyjeve që kulloten.

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,   e-mail: info@vaudejes.gov.al*

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Z.Mark Suli- inxhinjer, specialist zyra e pyjeve Bashkia Vau Dejës i cili spjegon se lista përmban llojin e kullotës, parcelat apo nënparcelat, sipërfaqen, vendndodhjen si dhe kapacitetin kullosor.Janë shqyrtuar dhe paraqitur për miratim lista e kullotave të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Vau i Dejes bazuar në VKM nr. 433 i ndryshuar dt 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të MM e të ish komunave/bashkive" i ndryshuar.Bazuar në Udhëzimin nr. 2/2016 të MM, pika 2 është bërë klasifikimi i kullotave të cilat propozohen për tu dhënë me qera. Këto janë kryesisht kullota verore sepse ky fond kullosor ndodhet në krahinën malore veriore, mbi 600 m lartësi.( pika 3.1).Nje pjese e kullotave jane ne zone me te ulet te cilat klasifikohen si kullota dimerore si ajo ne ekonomine pyjore Gjader Mnele Hajmel Nenshate. Mali i kakarriqit.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 9 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Z.Ervis Shimaj lexon piken 10 të rendit të ditës:**

Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalen Z.Mark Suli- inxhinjer, specialist zyra e pyjeve Bashkia Vau Dejës i cili spjegon se menaxhimi i aseteve është një pjesë e rëndësishme e qeverisjes lokale të mirë.Bashkia Vau Dejës ka një shtrirje gjeografike të gjërë që përfshin një sërë resursesh.Me transferimin e pronave në administrimin vendor, menaxhimi i aseteve publike bëhet një përgjegjësi e rëndësishme vendore në shërbim të shpërndarjes së zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin.Mendojmë se është një mundësi e mirë për përmirësimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit ekonomik të Bashkisë, i cili identifikon mundësitë e reja të zhvillimit ekonomik potencial. Bazuar në Ligjin nr.57/2020, datë 30.04.2020 "për pyjet", neni 25,mund të Zhvillohen aktivitete të ndyshme si punë kërkimore e studimore, për mbarështim të florës dhe faunës së egër, për baza didaktike apo eksperimentale, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike etj,për veprimtari biznesi dhe për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, gjeologjike e minerare, për gurore e kariera,pa cenuar vlerat dhe funksionet e tyre.

Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë diskutime apo pyetje.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin:**Miratohet me 18 vota Pro, zero vota kundra, zero vota abstenim**. Këshilltarët që votuan pro piken e 10 të rendit të ditës: (Ervis Shimaj, Frano Prenga, Majlinda Ndreca, Rita Preçi,Leonora Prenga, Ermir Tahiri, Kastriot Shkjau, Albina Livadhi, Edona Molla, Sanije Salja, Franga Kola, Ornela Lleshi, Arsen Mehmeti,Vjollcë Zagani, Mark Bisha.Rregjinë Shelqetja,Vijoleta Markolaj, Meliha Zyberaj).

**Pika 13 Të ndryshme:** Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje të ndryshme.Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime jashtë rendit të ditës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e Kshillit Bashkiak e datës 29.01.2026 deklarohet e mbyllur nga Kryetari Këshillit,

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian CELEPIJA**

Këshilltarët:

1. Evis Shiroj
2. Frano Prengo
3. Franga Ujkola
4. Ornela Lleshi
5. Majlinda Nohere
6. Rita Gjeçi
7. Leonora Prenga
8. Violeta Markolaj
9. Regjine Shelqetja
10. Ermir Tahiri
11. Kastriot Shkjeu
12. Arsen Mehmeti
13. Vjollca Zogaj
14. Albina Livadhi
15. Edona Molla
16. Gjovana Gjoni
17. Mark Bisha
18. Sean Dolja
19. Melita Gjebrea
20. 
21. 
22. 
23. 
24. 
25. 
26. 
27. 
28. 
29. 
30. 
31. 